



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 68, datë 17.03.2023

**PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË
RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.3, RRUGA "TEODOR RUPI",
PALLATI NR. 32, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË
DATËS 26 NËNTOR 2019**

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7850 datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr. 97/2019; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 202, datë 05.03.2020 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rindërtimit të banesave individuale”; Vendimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit nr.104, datë 08.07.2022; Urdhërit nr. 164, datë 01.07.2020 “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit”, i ndryshuar; Raportit të Komisionit të Posaçëm miratuar nga titullari i institucionit me nr. 2749/1 prot., datë 15.03.2023, si dhe sipas relacionit të hartuar nga ky komision, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin nr.32, Njësia Administrative nr.3, rruga “Teodor Rupi”, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, sipas Aneksit nr.1, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.



KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dymishi



U shpall sot me datë 21.03.2023

ANEKSI 1. SUBJEKTET PËRFITUESE TË PALLATIT NR.32, RRUGA "TEODOR RUPI"

Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATES	STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHET
1	ARTUR BENGASI, MERJEME BENGASI	4	2+1
2	ARTUR AZEMI, ETLEVA AZEMI	4	2+1
3	BESNIK THIKA, SHPRESA THIKA	5	3+1
4	MIMOZA SULEJMANI, SHPETIM SULEJMANI	4	2+1
5	ELVIN GASHI	6	3+1
6	ENTELE XHAFERAJ	3	2+1





BASHKIA DURRE
28/3/23 2702/4

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 201/prot.
7

Durrës, më 27 . 03 .2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.68 datë 17.03.2023 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësinë Administrative nr 3 Rruga Teodor Rupi, pall. Nr 32, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhërësive me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

